



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 979

Prishtinë, Dt. 21/03/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji- Biologji MScp
Projektpropozimi	Ndikimi i disa suplementeve bimore në përqendrimin e glukozës në serum te minjtë me diabet <i>'The Effects of Certain Herbal Supplements on the Glucose Concentration in the Serum of Diabetic Mice</i>
Kandidati	Arta Shala
Mentori	Prof.ass.dr. Ilir Mazreku
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë:
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.:
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Në temën shkruar kandidatja përshkruan dizajnin eksperimental dhe në mënyrë korrekte formulon konceptin e shtruar për hulumtim.</p> <p>Tema e Masterit përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-Tetë (8) kapituj që janë të parashikuar edhe në modelin e temës së masyerit në faqen e universitetit.</li><li>-Në kapitullin Hyrje, kandidatja përshkruan në hollësi problematikën e hulumtuar dhe elementet që duhet analizohen në lidhje me diabetin, kafshën eksperimentale, anatominë si dhe materialet me të cilat paraprakisht është trajtuar kafsha. Në detaje dhe me referenca jepen informacione në lidhje me efektet e këtyre kemikateve në spermatogjenezë, rrugëve të depërtimit dhe mekanizmin e veprimit të tyre.</li></ul>



-Në kapitullin Qëllimi, kandidatja përshkruan në detaje dhe saktë qëllimin dhe objektivat e hulumtimit.

-Në kapitullin Materiali dhe metodat kandidatja përshkruan të gjitha materialet e përdorura në hulumtim, për trajtim dhe për matjen e parametrave të spermogjenezës. Njëkohësisht ajo përshkruan metodologjinë e trajtimit të afshëve laboratorike, dhe matjeve të bëra të parametrave të rëndësishëm për çrregullimin e diabetit..

Tek rezultatet kandidatja në 4 tabela dhe dy grafikone paraqet rezultatet e pëpunuara statistikisht dhe komentimin e tyre.

Në kapitullin e diskutimit kandidatja përshkruan dallimet dhe ngjajshmëritë e rezultateve të saj dhe të autorëve tjerë, në parametrat e spermogramit tek minjt laboratorik.

E gjithë tema përfundon me konkluzionet e nxjerruara:

- Doza 50 mg/kg e STZ ishte e mjaftueshme për të shkaktuar induktimin e diabetit, pra për të krijuar minj të modelit diabetikë.
- Gjetjet e këtij studimi vërtetuan se minjtë refuzuan të konsumonin farën e zezë (*Nigella sativa*), një faktor që mund të ketë ndikuar në pamundësinë e vlerësimit të efektivitetit të saj në menaxhimin e diabetit. Ky refuzim mund të ketë qenë për shkak të shijes, teksturës ose ndonjë faktori tjetër të papritur që ndikon në shijet ushqimore të minjve.
- Një mundësi tjetër është se stresi i shkaktuar nga streptozotocina (STZ) mund të ketë kontribuar në refuzimin e suplementit, duke ndikuar në oreksin dhe sjelljen ushqimore të minjve. Duke pasur parasysh se suplementet bimore nuk u konsumuan siç ishte planifikuar, nuk mund të arriheshin rezultatet e pritura lidhur me uljen e niveleve të glukozës dhe përmirësimin e parametrave biokimikë.
- Në përfundim, refuzimi i suplementit të farës së zezë është një faktor kyç që ka ndikuar në mungesën e rezultateve pozitive në këtë hulumtim, dhe është e mundur që streptozotocina të ketë kontribuar në këtë refuzim përmes ndikimit të saj në metabolizmin dhe sjelljen ushqimore të minjve.
- Në studimet e ardhshme, mund të jetë e nevojshme të rishikohet forma e administrimit të suplementeve (p.sh., forma e pluhurit, kapsula, ose ekstrakte) për të përmirësuar konsumimin e suplementeve nga minjtë. Po ashtu, vlerësimi i mundësive të ndryshme të dozimit dhe trajtimit të suplementeve mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të



qarta dhe të besueshme.

- Një rezultat tepër interesant, që ndryshonte nga rezultatet e publikimeve tjera ishte se te ky hulumtim minjtë meshkuj më shumë i rezistuan dozës së STZ-së, me ndryshim prej femrave që ngordhën më shpejt, e nga publikimet tjera femrat i kanë rezistuar më shumë sasisë së STZ-së se sa minjtë meshkuj.
- Në përfundim, refuzimi i suplementit të farës së zezë është një faktor kyç që ka ndikuar në mungesën e rezultateve pozitive në këtë hulumtim, dhe është e mundur që streptozotocina të ketë kontribuar në këtë refuzim përmes ndikimit të saj në metabolizmin dhe sjelljen ushqimore të minjve. Kjo mund të jetë një aspekt i rëndësishëm për t'u marrë parasysh në hulumtimet e ardhshme në këtë fushë.

### III. Përfundimi dhe propozimi

Bazuar në atë që u tha me lartë konkludoj se tema Master *“Ndikimi i disa suplementeve bimore në përqendrimin e glukozës në serum te minjtë me diabet”* i kandidatës **Arta Shala**, është një punim i mirfilltë kërkimor-shkencor dhe pritet të jep një kontribut modest në fushën e shkencave mjedisore, me theks të veçantë në ekotoksikologjinë e ndotësve dhe suplementeve ushqimore, andaj i propozojmë KMSH të Departamentit të Biologjisë dhe të FSHMN-së të:

- propozojmë që të lëshohet vendimi për mbrojtje të temës të kandidatës **Arta Shala**

Prishtinë, \_\_\_\_\_

Komisioni:

1. \_\_\_\_\_

/ / Prof.Dr.Kemajl Bislimi – anëtar/

2. \_\_\_\_\_

Prof. ass.Dr.Ilir Mazreku – anëtar/mentor

3. \_\_\_\_\_

/Prof.Dr.Elez Krasniqi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.